

**VENDIM**  
**Nr. 104/2025**

**PËR NGRITJEN E NËNKOMISIONIT PËR AUDITIMIN E SEKTORIT PUBLIK**

*(Ndryshuar me vendimin nr. 112/2025, datë 12.12.2025)*

*(i përditësuar)*

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës dhe neneve 19, pika 2, 21, pika 1, dhe 55 të Rregullores së Kuvendit, me propozim të Konferencës së Kryetarëve,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

I. Ngritjen e Nënkomisionit për Auditimin e Sektorit Publik në përbërje të Komisionit të Përhershëm Parlamentar për Ekonominë, Punësimin dhe Financat.

II. Fusha e veprimtarisë së Nënkomisionit përfshin ndjekjen e:

a) zbatimit të buxhetit të shtetit gjatë vitit buxhetor, performancën e treguesve për programet buxhetore, duke marrë informacion nga Ministria e Financave/njësitë e qeverisjes së përgjithshme;

b) veprimtarisë ekonomike të institucioneve të qeverisjes qendrore, organeve të pushtetit vendor, institucioneve të tjera qendrore dhe vendore, që kryejnë funksione publike, institucioneve të pavarura e shoqërive tregtare apo të çdo forme tjetër, të audituara nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, në auditime të përputhshmërisë, financiare, të performancës, të IT- së, si dhe në auditimin e kombinuar të tyre;

c) zbatueshmërisë së rekomandimeve të raporteve të auditimit, të përfunduara nga Kontrolli i Lartë i Shtetit;

ç) zbatueshmërisë së buxhetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

III. Kompetencat e Nënkomisionit janë:

a) të ndjekë gjatë vitit procesin e zbatimit të buxhetit të shtetit dhe të shqyrtojë raportet e veçanta të auditimit për ato subjekte të audituara nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, përgjegjëse për hartimin, miratimin, ekzekutimin, raportimin dhe përputhshmërinë e buxhetit faktik të vitit paraardhës. T'i paraqesë Komisionit për Ekonominë, Punësimin dhe Financat raportin përmbledhës me rekomandimet e Nënkomisionit përpara shqyrtimit të raportit vjetor të konsoliduar të zbatimit të buxhetit;

b) të shqyrtojë raportet e auditimit, të evaduara nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, në përputhje me kalendarin dhe programin e punës së Nënkomisionit dhe të përgatisë një raport për rezultatet e dala nga shqyrtimi i këtyre raporteve;

c) të shqyrtojë raportet periodike për zbatimin e rekomandimeve, të përcjella nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, si dhe t'u kërkojë organeve kompetente marrjen e masave për plotësimin e tyre brenda një periudhe kohe të caktuar, nëse e gjykon të arsyeshme;

ç) të miratojë raportin e veprimtarisë së Nënkomisionit për vitin paraardhës në fund të vitit kalendarik dhe t'ia paraqesë atë Komisionit për Ekonominë, Punësimin dhe Financat;

d) të zhvillojë procedurat për përzgjedhjen e grupit të audituesve të pavarur, të cilët do të auditojnë llogaritë financiare të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe t'i propozojë Komisionit për Ekonominë, Punësimin dhe Financat përzgjedhjen e tyre;

dh) të shqyrtojë projektbuxhetin e Kontrollit të Lartë të Shtetit për vitin pasardhës dhe t'i paraqesë Komisionit për Ekonominë, Punësimin dhe Financat raportin përkatës së bashku me rekomandimet për miratimin e shtesave për fondet buxhetore të planifikuara, nëse ka të tilla;

e) të organizojë vizita apo takime monitoruese pranë subjekteve të audituara dhe të përgatisë një raport në fund të tyre me vlerësimet përkatëse.

IV. Nënkomisioni përbëhet nga anëtarë 7, si më poshtë:

|              |            |
|--------------|------------|
| 1. Igli Cara | kryetar PD |
|--------------|------------|

|                          |                       |
|--------------------------|-----------------------|
| 2. <i>Antoneta Dhima</i> | <i>nënkryetare PS</i> |
| 3. Ermal Elezi           | anëtar PS             |
| 4. Andi Qose             | anëtar PS             |
| 5. Zamira Sinaj          | anëtare PS            |
| 6. Besart Xhaferi        | anëtar PD             |
| 7. Ledina Alolli         | anëtare PL            |
| 8. <i>Saimir Salla</i>   | <i>anëtar PS</i>      |
| 9. <i>Elda Hoti</i>      | <i>anëtare PD</i>     |

Anëtarë zëvendësues:

1. Onid Bejleri PS

2. *Xhelal Mziu PD*

V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR  
**Niko Peleshi**

Miratuar në datën 4.12.2025.